AKTIV

Advocacy Center for Democratic Culture

DORACAK PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

OJQ AKTIV,
MITROVICA E VERIUT, DHJETOR 2024

Doracak për parandalimin e korrupsionit

Doracak i udhëhequr nga:
OJQ AKTIV

Autorët:
Sanja Vuković
Miodrag Milićević

Redaktorja:
Ilda Krama

Dizajni:
Darija Viro

Donator:
Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjit (INL)

Botuar nga:
OJQ AKTIV

Adresa:
Kralja Petra 183a,
Mitrovica e Veriut

Email:
info@ngoaktiv.org

Uebsajti:
www.ngoaktiv.org

Mitrovica e Veriut,
Dhjetor 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje 7

Përkufizimi dhe llojet e korrupsionit 9

Përkufizimi i korrupsionit 11

Format e korrupsionit 11

Çfarë nuk është korrupsioni? 13

Korrupsioni – konventat detyruese dhe korniza ligjore 15

Instrumentet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit 17

Korniza ligjore vendore në luftën kundër korrupsionit 19

Strategjia kombëtare për luftën kundër korrupsionit 20

Institucionet në luftën kundër korrupsionit 21

Shembuj nga praktika – Agjencia Kosovare e Privatizimit 25

Raportimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për rastin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit 28

Agjencia Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit – APK 29

Mandati i Agjencisë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit 31

Sinjalizuesi 33

Të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve 35

Qasja në dokumente publike - hapi i parë në luftën kundër korrupsionit 37

Agjencia për Informim dhe Privatësi 39

E drejta për qasje në dokumente publike 40

Mediat dhe shoqëria civile - kontrolli publik i punës së institucioneve 41

OJQ AKTIV – partner aktiv në luftën kundër korrupsionit 46

Përmirësimi i transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe 47

Korrupsioni digjital – sfidat e epokës moderne 48

Kripto dhe korrupsioni – Kuptimi i sfidave dhe mundësive 48

Graçanica – Mes betonit dhe natyrës 49

Edukimi i të rinjve të Graçanicës për luftën kundër korrupsionit 49

Rekomandime 53

Rekomandime për institucione 53

Rekomandimet për mediat dhe shoqërinë civile 54

Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mediave dhe shoqërisë civile 56

Rekomandime për qytetarët 56

Si të raportohet korrupsioni në Kosovë? 57

Çfarë duhet të përmbaj raportimi i rasti? 60

Platforma të tjera për raportimin e korrupsionit 60

Aplikacioni ABER 60

Platforma online Kallxo.com 61

Hyrje

Korrupsioni paraqet një nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe prosperuese. Lufta kundër këtij fenomeni si në shumë vende të tjera në tranzicion ashtu edhe në Kosovë është sfidë kryesore. Minon besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore, pengon rritjen ekonomike, ndikon në sundimin e ligjit dhe cenon vlerat bazë të demokracisë.

Kosova me skenën e saj dinamike politike dhe sociale përballet me sfida unike, por edhe me mundësi për të parandaluar korrupsionin.

Përmes mekanizmave adekuat, edukimit dhe angazhimit të të gjithë qytetarëve, mund të krijohet një mjedis i cili prioritizon ligjin dhe drejtësinë dhe redukton korrupsionin në minimum.

Ky doracak është hartuar për të ofruar udhëzime të qarta dhe konkrete për identifikimin, kuptimin, luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë. Është i dedikuar si për nëpunësit civilë ashtu edhe për qytetarët, shoqërinë civile dhe sektorin privat, me qëllim që t'i fuqizojë ata për të ndërmarrë hapa drejt ndërtimit të një shoqërie në të cilën sundimi i ligjit, transparenca dhe përgjegjësia bëhen themel i jetës së përditshme.

Sipas kornizës aktuale ligjore, korrupsioni në Kosovë përkufizohet si keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar për përfitime personale apo përfitime për një palë të tretë në kundërshtim me ligjin. ***Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik***[1] dhe ***Ligji nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave***[2], përfshijnë forma të ndryshme të sjelljes korruptive, si dhënien dhe marrjen e ryshfetit, keqpërdorimin e autoritetit zyrtar, shpërdorimin e fondeve publike dhe ndikimin e paligjshëm.

Qëllimi i këtij Doracaku është të forcojë transparencën, llogaridhënien dhe standardet etike në një vend ku korrupsioni është sfidë domethënëse. Gjithashtu, një segment i rëndësishëm i këtij doracaku është ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe punonjësve në sektorin shtetëror dhe privat për rreziqet që sjell korrupsioni, si dhe efektet negative të tij në ekonomi, drejtësi dhe zhvillim social.

Doracaku me promovimin e integritetit në të gjithë sektorët dhe ofrimin e mjeteve praktike, të përshtatura

1] Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i qasshëm në linkun: https://APK-ks.org/assets/cms/uploads/files/Agjencia/Legjislacioni%20vendas/ZAKON_BR._06_L-011__O_SPRECAVANJU_SUKOBA_INTERESA_PRI_VRSENJU_JAVNE_FUNKCIJE.pdf

2] Ligji nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, i qasshëm në linkun: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A3FF2913-82C8-4E5F-9850-09CE90383AFA.pdf

me nevojat specifike të Kosovës, në identifikimin dhe parandalimin e korrupsionit, ka për qëllim rritjen e transparencës në punën e institucioneve dhe forcimin e standardeve etike.

Një fokus i veçantë i kushtohet mbrojtjes së sinjalizuesve, për të inkurajuar raportimin e korrupsionit pa frikë nga hakmarrja. Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave në të gjitha nivelet do të jetë një segment i rëndësishëm i Doracakut, sepse përmes rrjetëzimit dhe bashkëpunimit lufta kundër korrupsionit do të zhvillohet në mënyrë më efektive.

Së fundi, monitorimi dhe mbikëqyrja e masave kundër korrupsionit do të mundësojë monitorimin e progresit për t'u siguruar që masat e marra janë duke u zbatuar. Përmes trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, Doracaku do të shërbejë në forcimin e ekspertizës së punonjësve në luftën kundër korrupsionit, duke krijuar kështu themele të forta për stabilitet dhe transparencë afatgjate në Kosovë.

Përkufizimi dhe llojet e korrupsionit

Përkufizimi i korrupsionit

Korrupsioni nuk ka një përkufizim botërisht të pranuar, sepse kuptimi i tij ndryshon në varësi të shtetit, institucionit apo formës së shfaqjes. Megjithatë, të gjitha përkufizimet e korrupsionit kanë një element të përbashkët: ka gjithmonë një nëpunës ose zyrtar publik të cilit i janë besuar kompetencat publike, e i cili ato kompetenca i përdor për përfitime private. Ndërsa nga ana tjetër, në aktin korruptiv merr pjesë edhe një akter jopublik, si sipërmarrësi, qytetari, organizata e shoqërisë civile apo ndonjë akter tjetër publik, i cili kërkon përfitim nga zyrtari. Prandaj, korrupsioni përfshin të paktën dy akterë, ku të dyja palët përfitojnë nga kjo marrëdhënie.

Korrupsioni është një proces dinamik në të cilin individët ose grupet përdorin fuqinë, pozicionin ose burimet e tyre për të përmbushur interesat personale, shpesh në dëm të shoqërisë dhe duke shkelur normat etike. Paraqet shkelje të besimit dhe parimeve të drejta, ku transparenca dhe llogaridhënia zëvendësohen me marrëveshje të fshehtë, ryshfet ose shpërdorim të autoritetit, duke cenuar kështu funksionin themelor të institucioneve dhe besimin e publikut.

Format e korrupsionit

Korrupsioni në varësi të metodës, fushëveprimit dhe pjesëmarrësve në veprime korruptive shfaqet në forma të ndryshme. Llojet më të zakonshme të korrupsionit janë:

RYSHFETI (DHËNIA E RYSHFETIT)

Ryshfeti nënkupton ofrimin e parave, shërbimeve ose përfitimeve të tjera për të ndikuar në vendimin e një zyrtari ose personi në pozitë. Ky lloj korrupsioni mund të ndodhë në nivele të ndryshme, qoftë për marrjen e kontratave, shmangien e sanksioneve ligjore apo sigurimin e privilegjeve të veçanta.

PËRVETËSIMI

Përvetësimi përfshin keqpërdorimin ose përvetësimin e fondeve që i janë besuar dikujt për t'i menaxhuar. Mund të jenë para publike, resurse ose prona, të cilat në vend të qëllimit për të cilin janë dedikuar përdoren për interesa personale ose për interesa të personave të afërt.

FAVORITIZMI DHE NEPOTIZMI

Këto lloje të korrupsionit përfshijnë favorizimin e individëve të caktuar bazuar në marrëdhënie personale në vend të meritës.

Favoritizmi ndodh kur preferenca u jepet personave ose grupeve të caktuara pavarësisht nga kualifikimet e tyre.

Nepotizmi është dhënia e vendeve të punës, kontratave ose përfitimeve të tjera për anëtarët e familjes, miqtë ose të afërmit.

NDIKIMI I PALIGJSHËM → Ndikimi i paligjshëm i referohet ushtrimit të ndikimit politik ose shoqëror për arritjen e qëllimeve të caktuara, të tilla si marrja e punës, kontratës ose marrja e vendimeve në favor të palëve të interesit.

KEQPËRDORIMI I POZITËS ZYRTARE → Ky është një lloj korrupsioni në të cilin një person në pozitë zyrtare përdor fuqitë dhe ndikimin e tij për përfitime personale ose për të tjerët që nuk janë në përputhje me ligjin ose rregullat e institucionit.

KORRUPSIONI SISTEMIK (INSTITUCIONAL) → Ky lloj korrupsioni është gjerësisht i përhapur dhe është pjesë e funksionimit normal të institucioneve. Shpesh ndodh kur sisteme të tëra politike dhe ekonomike preken nga praktikat korruptive dhe korrupsioni bëhet normë.

KORRUPSIONI „I VOGËL" DHE „I MADH" → *Korrupsioni i vogël* përfshin raste të përditshme të dhënies së ryshfetit ose përfitimeve në shuma të vogla, p.sh. duke i dhënë para një policit ose zyrtarit për ta përpunuar më shpejt kërkesën.

Korrupsioni i madh ndodh në nivelet më të larta, ku shuma të mëdha parash dhe burimesh vihen në lojë, zakonisht me përfshirjen zyrtarëve të rangut të lartë dhe ndërmarrjeve të mëdha.

KORRUPSIONI POLITIK → Korrupsioni politik i referohet keqpërdorimit të pushtetit politik për përfitime personale ose përforcim të pushtetit politik. Këtu mund të përfshihet manipulimi i zgjedhjeve, korruptimi i anëtarëve të parlamentit ose keqpërdorimi i resurseve shtetërore për fushata politike.

Secili prej këtyre llojeve të korrupsionit ka pasoja negative për shoqërinë, nxit padrejtësinë, humbjen ekonomike si dhe dobëson besimin e qytetarëve në institucione.

Çfarë nuk është korrupsioni?

Dhuratat për zyrtarët publikë mund të përbëjnë korrupsion, por e gjithë kjo varet nga rrethanat dhe vlera e dhuratës. Në shumë vende ka ligje dhe rregullore me të cilat kjo fushë rregullohet. Në disa vende për shembull një konsideratë ose kujdes i vogël në formë të mirënjohjes apo dhuratës simbolike mund të jetë i pranueshëm, ndërsa dhuratat më të mëdha ose ato që jepen në pritjen në këmbim të diçkaje mund të konsiderohen si korrupsion.

Në Kosovë, çështjet e dhuratave, deklarimit të pasurisë dhe kontrollit janë të rregulluara me ***Ligjin nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave***[3], i cili është miratuar në vitin 2022. Ky ligj përcakton rregullat se si zyrtarët publikë për të parandaluar shpërdorimin e detyrës dhe korrupsionin duhet të deklarojnë dhuratat dhe pasurinë e tyre.

Ligji parashikon detyrimin për të raportuar dhuratat që kalojnë një vlerë të caktuar, dhe sanksionimin e atyre që janë në kundërshtim me ligjin. Me miratimin e këtij ligji, Kosova ka ndërmarrë hapa drejt forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve publikë, dhe është pjesë e një strategjie më të gjerë në luftë kundër korrupsionit.

3] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304

Korrupsioni – konventat detyruese dhe korniza ligjore

Lufta kundër korrupsionit për shumicën e vendeve që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian, përfshirë Kosovën paraqet një nga sfidat kryesore në fushën e sundimit të ligjit. Kjo luftë është e lidhur ngushtë me ruajtjen e të drejtave themelore të njeriut, punën efikase të organeve dhe institucioneve gjyqësore, drejtësinë dhe punët e brendshme. Duke qenë se lufta kundër korrupsionit duhet marrë seriozisht tashmë në fazat e hershme të procesit të anëtarësimit, hapja e kapitujve përkatës varet nga rezultatet bindëse, dhe Kosova duhet të tregojë vendosmëri në zbatimin e masave konkrete, gjithëpërfshirëse dhe afatgjata në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Instrumentet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit

Janë katër konventa kyçe në luftën kundër korrupsionit, në të cilat janë aderuar shumë vende anëtare të OSBE-së:

1 ***Konventa mbi luftën kundër ryshfetit të zyrtarëve të huaj në transaksionet afariste ndërkombëtare***[4] (OECD) (1997). Kjo konventë, e njohur si Konventa kundër ryshfetit, fokusohet në parandalimin e ryshfetit të zyrtarëve të huaj në afarizmin ndërkombëtar.

2 ***Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale mbi Korrupsionin***[5] (1999) dhe Protokolli shtesë i Konventës për të drejtën penale mbi korrupsionin (2003)[6]. Këto konventa vendosin standarde ligjore për ndjekjen penale të korrupsionit dhe zgjerojnë fushëveprimin dhe detyrimet e shteteve anëtare.

3 ***Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Civile mbi Korrupsionin***[7] (1999.). Kjo konventë fokusohet në aspektet e të drejtës civile në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë mundësinë e kompensimit të dëmeve.

4 ***Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit***[8] (2003). Kjo Konventë gjithëpërfshirëse ofron një kornizë globale për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë masat parandaluese, sanksionet penale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

4] https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/fighting-foreign-bribery.html
5] Këshilli i Evropës, raporti me sqarime, Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtat Penale mbi Korrupsionin http://conventions.coe.int/treaty/en/reports/Html/173.htm
6] https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=191
7] https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=174
8] https://www.unodc.org/documents/brussels/UN_Convention_Against_Corruption.pdf

Kosova, si territor që nuk është anëtare e plotë e organizatave ndërkombëtare siç është OSBE-ja, nuk është automatikisht e obliguar që t'i përmbahet konventave të përmendura ashtu siç obligohen shtetet anëtare. Megjithatë, shumë nga këto konventa mund të jenë relevante për Kosovën për shkak të detyrimeve të saj ndërkombëtare, partneritetit me BE-në dhe detyrimeve që i takojnë në bazë të marrëveshjeve dhe aranzhimeve me organizatat ndërkombëtare.

Për shembull, Kosova, ka nënshkruar dhe ratifikuar ***Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit*** (2003), që do të thotë se është e obliguar që në kuadër të kapaciteteve ligjore dhe institucionale të respektojë dispozitat e saj. Po ashtu, Kosova mund të detyrohet të respektojë disa standarde dhe norma ndërkombëtare të përcaktuara nga ato konventa, veçanërisht në kontekstin e aspiratave të saj për integrim në BE dhe partneritete ndërkombëtare.

Korniza ligjore vendore në luftën kundër korrupsionit

Në Kosovë, lufta kundër korrupsionit është e rregulluar me ligjet në vijim:

- ***Ligji nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit***[9]

  Ky ligj ka për qëllim që të rregullojë statusin dhe kompetencat Agjencisë për Parandalimin Korrupsionit, me synim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, veçanërisht në raportimin, zbulimin dhe hetimin e korrupsionit, zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin e korrupsionit.

- ***Ligji nr. 08/I-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave***[10]

  Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë për ta deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen e tyre, detyrën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për të kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë personave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

- ***Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik***[11]

  Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit të interesit në interesat publike dhe private të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve publike.

- ***Ligji nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve***[12]

  Qëllimi i këtij ligji është mundësimi i sinjalizimit të shkeljeve në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtja e sinjalizuesve.

Duke qenë se transparenca është një nga mjetet më efektive në luftën kundër korrupsionit, do të përmendim edhe disa ligje dhe akte nënligjore të rëndësishme që rregullojnë çështjen e transparencës:

1. Ligji nr.06/L-081 për qasje në dokumente publike[13]
2. Ligji nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale[14]
3. gji nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë[15]***, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05-L-007 05/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/I-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr.03/I-221, Nr.04/I-116, Nr. 04/I-194 dhe Nr. 05/I-063***
4. Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve[17]

9] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60591
10] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61304
11] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314
12] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303
13] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505
14] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530
15] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524
16] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12387
17] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440

Strategjia kombëtare për luftën kundër korrupsionit

Kosova që nga viti 2018, kur Strategjia e fundit ka skaduar, nuk ka miratuar strategji të re. Qeveria, pas asaj hartoi një dokument të ri që nuk kaloi kurrë në Kuvend. Gjashtë vite pas skadimit të Strategjisë së mëparshme, hartimi i Strategjisë Kombëtare është ende në vazhdim dhe sipas raportit të Institutit të Kosovës për Drejtësi – IKD, të publikuar në janar të vitit 2024, drafti i Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit ka probleme thelbësore lidhur me konceptet bazë të sundimit të ligjit.

Institucionet në luftën kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit paraqet një sfidë komplekse që kërkon veprim të bashkërenduar të institucioneve dhe autoriteteve të ndryshme. Lufta e suksesshme kundër këtij fenomeni varet jo vetëm nga fuqizimi i ligjit, por edhe nga efikasiteti i institucioneve që zbatojnë ato ligje, dhe bashkëpunimi i tyre reciprok. Institucionet e përfshira në luftën kundër korrupsionit jo vetëm se kanë role të përcaktuara qartë por janë edhe të lidhura me detyrime ligjore dhe mekanizma institucionalë që mundësojnë veprime të koordinuara.

Pushteti legjislativ luan një rol kyç në krijimin e kornizës ligjore që përkufizon korrupsionin, format, sanksionet dhe procedurat për luftimin dhe parandalimin e tij. Ligjvënësit, përmes akteve ligjore, vendosin themelet për punën e të gjitha institucioneve të tjera. Pa një kornizë të fortë ligjore, lufta kundër korrupsionit do të ishte e fragmentuar dhe joefektive. Përveç krijimit të ligjeve, pushteti legjislativ, mbikëqyr edhe zbatimin e tyre, duke siguruar kështu kontrollin institucional në luftën kundër korrupsionit.

Nga ana tjetër, ***pushteti ekzekutiv***, veçanërisht përmes agjencive të specializuara si organet kundër korrupsionit, merr përgjegjësinë për zbatimin e këtyre ligjeve. Këto agjenci kanë mandate të monitorojnë zyrtarët publikë, të analizojnë të dhënat e tyre pronësore, të hapin hetime dhe të marrin masa parandaluese. Agjencitë kundër korrupsionit funksionojnë si organe të pavarura, gjë që u mundëson atyre autonomi dhe efikasitet më të madh në zbatimin e masave pa presion politik. Roli i tyre është vendimtar në ngritjen e mekanizmave parandalues, si dhe në zbulimin dhe hetimin e rasteve të mundshme të korrupsionit.

Institucionet gjyqësore, si gjykatat dhe prokuroritë, janë përgjegjëse për ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Pavarësia dhe ekspertiza e tyre janë faktorë kyç për një gjykim të drejtë dhe ndëshkim të autorëve. Prokuroritë janë zakonisht pika e parë e kontaktit për zbatimin e ligjit kur bëhet fjalë për akuzat për korrupsion. Bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe agjencive kundër korrupsionit është i një rëndësie vendimtare, sepse prokuroria për të përgatitur në mënyrë efektive aktakuzat varet nga informacioni i ofruar nga agjencitë. Gjykatat, nga ana e tyre, kanë për detyrë të interpretojnë saktë ligjet dhe të sigurojnë zbatimin e drejtë të sanksioneve.

Përveç ***autoriteteve gjyqësore***, rol kyç luajnë edhe autoritetet hetimore, si policia dhe njësitë e specializuara për luftimin e krimit financiar. Ata ushtrojnë detyra teknike dhe operative, mbledhin prova, kryejnë arrestime dhe ndihmojnë në krijimin e dyshimeve të arsyeshme që autoritetet gjyqësore përdorin në procedimin penal. Bashkëpunimi i tyre i ndërsjellë me prokurorinë dhe agjencitë kundër korrupsionit shpesh përfshin shkëmbimin e informacionit, operacionet e përbashkëta dhe shkëmbimin e burimeve.

Organet e pavarura, si ***institucionet e auditimit dhe Institucioni i Avokatit të Popullit***, kanë për detyrë të sigurojnë transparencë në punën e institucioneve publike dhe përgjegjësinë e tyre ndaj qytetarëve. Institucionet e auditimit ushtrojnë kontroll mbi shpenzimin e fondeve publike, duke parandaluar kështu keqpërdorimet që mund të çojnë në korrupsion. Këto organe veprojnë në mënyrë parandaluese dhe me rastin e zbulimi të parregullsive në punën e institucioneve shtetërore mund të jenë burime kyçe të informacionit për autoritetet tjera kompetente.

Institucionet në luftën kundër korrupsionit nuk veprojnë në mënyrë të pavarur. Lidhja e tyre e ndërsjellë, e bazuar në detyrimet ligjore dhe mekanizmat e bashkëpunimit institucional, është çelësi për ndërtimin e një sistemi efektiv për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Vetëm nëpërmjet veprimit të koordinuar dhe të sinkronizuar të këtyre organeve mund të arrihen rezultate të rëndësishme në luftën kundër këtij fenomeni të dëmshëm shoqëror.

Shembuj nga praktika – Agjencia Kosovare e Privatizimit

Korrupsioni në Kosovë është një problem i kahershëm që prek shoqërinë, ekonominë dhe proceset politike. Ka shumë raste konkrete të korrupsionit që tërhoqën vëmendjen e publikut dhe patën pasoja të konsiderueshme, mirëpo ajo që më së shpeshti është akuzuar dhe hetuar nga autoritetet gjyqësore për praktika të ndryshme korruptive është Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) para organeve hetuese dhe gjyqësore është e ndërlidhur me korrupsion, keqpërdorim të pozitës dhe procese jo transparente të privatizimit të ndërmarrjeve dhe pronës shtetërore pas luftës së vitit 1999. AKP, e themeluar për qëllime të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore të trashëguara nga periudha jugosllave, është bërë sinonim i aktiviteteve të dyshimta, interesave politike dhe pasurimit të individëve të afërt me pushtetin.

Hetimet dhe procedurat kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërmjet organeve gjyqësore vendore dhe misioneve ndërkombëtare, ndërsa raportet e institucioneve të ndryshme kompetente tregojnë për shumë parregullsi në punën e AKP-së që kanë të bëjnë me aktivitete korruptive, si:

PROCESI JO TRANSPARENT I PRIVATIZIMIT

AKP-ja është përgjegjëse për shitjen ose ristrukturimin e aseteve të shumë ndërmarrjeve që ishin në pronësi të shtetit ose kooperativave të punëtorëve. Procesi i privatizimit, megjithatë, shpesh nuk ishte transparent dhe shumë ndërmarrje u shitën me çmime dukshëm më të ulëta se vlera e tregut. Në shumë raste, ndërmarrjet janë blerë nga persona që kishin lidhje me parti politike ose nga ata me lidhje të fuqishme brenda autoriteteve kosovare.[18]

PARREGULLSI NË TENDERË DHE KONTRATA

Gjatë privatizimit kishte parregullsi të shumta në dhënien e tenderëve si dhe pretendime se individë në Agjenci përmes manipulimit të dokumenteve[19], dhënies së informacioneve të privilegjuara dhe vlerësimit jo të duhur të pasurisë[20] kanë favorizuar blerësit e caktuar. Këto marrëveshje u mundësonin individëve të blinin prona e asete me çmime të ulëta për t'i shitur pastaj me çmime dukshëm më të larta.

18] EULEX Kosova, Raporti mbi mbikëqyrjen e drejtësisë, Gjetjet dhe rekomandimet nëntor 2021 – shtator 2022, Ish-çështjet e EULEX-it, i disponueshëm në: serbisht https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/ Raporti_Serbisht.pdf anglisht https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Raporti_Anglisht.pdf

19] https://www.slobodnaevropa.org/a/25368344.html?utm_source=chatgpt.com

20] EULEX Kosova, Raporti mbi mbikëqyrjen e drejtësisë, Gjetjet dhe rekomandimet nëntor 2021 – shtator 2022, Ish-çështjet e EULEX-it, i disponueshëm në: serbisht https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/ Raporti_Serbisht.pdf anglisht https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Raporti_Anglisht.pdf

PËRFSHIRJA POLITIKE

Privatizimi në Kosovë shpesh ishte i lidhur me interesa politike. Pati pretendime se shumë nga blerësit ishin të afërt me partitë kryesore politike, si Partia Demokratike e Kosovës (PDK)dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)[21]. Anëtarët e këtyre partive dyshohet se përdorën pushtetin politik për të fituar kontrollin ndaj ndërmarrjeve të vlefshme shtetërore.

ASETET E NDËRMARRJEVE NË DIASPORË DHE JASHTË VENDIT[22]

Kosova përveç ndërmarrjeve vendore kishte asete e prona edhe jashtë vendit, të cilat po ashtu ishin objekt i privatizimit. Ka pretendime se shitja e këtyre aseteve e pronave ka qenë edhe më pak transparente, dhe në vend që të kontribuojë në interesa publike apo në rindërtimin e ekonomisë së Kosovës vlera e konsiderueshme e këtyre aseteve e pronave ka shkuar në duart e njerëzve me lidhje politike dhe afariste.

PASOJAT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK[23]

Një nga problemet kryesore të privatizimit nën udhëheqjen e AKP-së ishte se shumë ndërmarrje të privatizuara nuk arritën të revitalizojnë prodhimin, të punësojnë popullsinë vendase apo të sjellin rritje ekonomike. Përkundrazi, shumë ndërmarrje u mbyllën menjëherë pas privatizimit, gjë që çoi në ulje të punësimit dhe stagnim të mëtejshëm ekonomik. Shumë punëtorë humbën punën dhe pa kompensim adekuat, ndërkohë që pronat e paluajtshme dhe tokat ku ndodheshin ndërmarrjet përdoreshin shpesh për spekulime në tregun e pasurive të paluajtshme.

21] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, Case I, NBI Suhareka (AgroKosova Holding), dostupan na https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

22] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, i disponueshëm në https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

23] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, i disponueshëm në https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

Shembuj të ndërmarrjeve dhe aseteve që ishin nën hetim

GRAND HOTEL, PRISHTINË

Një nga rastet më të njohura lidhur me privatizimin ishte përpjekja për shitjen e hotelit Grand në Prishtinë. Ky hotel, i cili ishte një nga burimet më të vlefshme shtetërore, u shit me një çmim më të ulët se sa pritej, gjë që shkaktoi polemika të mëdha dhe akuza për korrupsion. Kundër privatizimit të hotelit Grand, një nga simbolet më të njohura të qytetit dhe një aset i rëndësishëm shtetëror, ishin disa akterë, përfshirë sindikatat, partitë politike, ish-punonjësit e hotelit dhe një pjesë e publikut. Pas shumë proceseve gjyqësore, AKP-ja në vitin 2012 e ktheu ndërmarrjen nën menaxhimin e saj. Privatizimi u anulua, ndërsa blerësi i mëparshëm përmes proceseve gjyqësore po konteston procesine riprivatizimit.[24]

TREPÇA

Një nga ndërmarrjet më të vlefshme në Kosovë, kompleksi i minierave Trepça, ishte gjithashtu objekt i një kontesti të privatizimit. Përderisa shumë nga ndërmarrjet më të vogla në përbërje të Trepçës u privatizuan, kishte pretendime e akuza për ushtrim të presionit për shitjen e minierave nën vlerën e tyre për përfitime e interesa private[25].

HETIMET DHE EPILOGU GJYQËSOR

Gjatë viteve, janë iniciuar disa hetime për akuzat për korrupsion dhe shpërdorim detyre lidhur me privatizimin. Megjithatë, shumë hetime përfunduan pa aktgjykime konkrete apo procese gjyqësore që zgjatën shumë, duke çuar në një ndjenjë mosndëshkimi. Bashkimi Evropian, i cili ishte i përfshirë në mbikëqyrjen dhe mbështetjen e institucioneve gjyqësore në Kosovë, përmes misionit të tij EULEX, ka iniciuar disa hetime për aktivitetet e AKP-së, megjithatë rezultatet shpesh ishin të pakënaqshme.[26]

24] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, Case I, NBI Suhareka (AgroKosova Holding), dostupan na https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

25] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, i disponueshëm në https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

26] BIRN Kosovo, Panic selling - Assessing the main challenges and deficiencies of Kosovo's privatization process, i disponueshëm në https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2017/12/Report-on-Privatization.pdf

PASOJAT

PASOJAT EKONOMIKE

Privatizimi jo transparent e varfëroi ekonominë kosovare, duke qenë se shumë resurse të vlefshme kaluan në duart e individëve privatë dhe shteti humbi burime të konsiderueshme të të ardhurave.

PASOJAT POLITIKE

Rasti i AKP-së thelloi ndjenjën e korrupsionit politik në Kosovë si dhe thelloi mosbesimin e qytetarëve ndaj institucioneve.

PASOJAT SOCIALE

Punëtorët e shumtë, veçanërisht në sektorin industrial, humbën vendet e punës dhe perspektivat për punësim, ndërsa ndërmarrjet e privatizuara shpesh u mbyllën e shkatërruan.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është bërë simbol i dështimit të autoriteteve kosovare për të vendosur reforma ekonomike transparente dhe të drejta, ndërkohë që në kurriz të shoqërisë kanë përfituar elitat politike dhe ekonomike.

Raportimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për rastin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit (APK) nuk kishte kompetenca të drejtpërdrejta për të kryer hetime penale apo për të iniciuar procedura lidhur me korrupsionin, por ishte kryesisht përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit, monitorimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, hartimin e strategjive kundër korrupsionit dhe dhënien e rekomandimeve për autoritetet gjyqësore.

Mirëpo, kur bëhet fjalë për privatizimin dhe aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), ka pasur disa raste në të cilat APK-ja ka treguar për parregullsi të mundshme dhe rreziqe të korrupsionit të mundshëm në procesin e privatizimit. APK kishte autoritetin për hetimin e parregullsive që kishin të bonim me me konfliktin e interesit dhe shpërdorimin e detyrës, por hetimet penale ishin nën juridiksionin e institucioneve gjyqësore, si Prokuroria Speciale e Kosovës dhe gjykatat, si dhe EULEX-i që monitoronte rastet e korrupsionit të profilit të lartë.

Megjithatë, një numër i madh i këtyre hetimeve nuk rezultuan me aktgjykime serioze, gjë që tek qytetarët shkaktoi frustrim dhe krijoi një ndjenjë mosndëshkimi për elitat politike dhe ekonomike të përfshira në procesin e privatizimit.

Edhe pse Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë theksoi problemet që ndërlidhen me privatizimin dhe konfliktin e interesit brenda AKP-së, roli i saj ishte i kufizuar në parandalimin dhe dhënien e rekomandimeve, ndërsa hetimet dhe sanksionet specifike ishin përgjegjësi e institucioneve të tjera gjyqësore.[27]

27] Kosova Democratic Institute, Transparency International Kosova, Vlerësimi i sistemit të integritetit kombëtar të Kosovës, i disponueshëm (në serbisht) në: https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/73-kdi-nis-srb_all_single_final.pdf anglisht: https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/72-kdi-nis-eng_all_single_final.pdf shqip: https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/publikime/71-kdi-nis-alb_all_single_final.pdf

Agjencia Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit – APK

Agjencia Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit (APK) është institucion i pavarur shtetëror që merret me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, i cili për punën e tij i raporton Kuvendit të Kosovës.

Mandati i Agjencisë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit

Mandati i Agjencisë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit (APK) përfshin një gamë të gjerë të përgjegjësive që kanë të bëjnë me parandalimin, monitorimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është përgjegjëse për zbatimin e disa ligjeve kyçe për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke përfshirë:

- **Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit**
- **Ligjin nr. 08/I-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave**
- **Ligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve**

Agjencia në përputhje me ligjet:

- punon në parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit me dhënien e opinioneve dhe kryen hetime administrative lidhur me pretendimet e konfliktit të interesit,
- kryen hetime administrative dhe shqyrton raportimet e marra nga sinjalizuesit e jashtëm,
- kryen kontroll të plotë të deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve dhe përcakton saktësinë e deklarimeve të tyre dhe monitoron pranimin e dhuratave nga zyrtarët.

Gjithashtu, Agjencia shqipton gjoba për zyrtarët që nuk përmbushin detyrimin e tyre për deklarim me kohë të pasurisë ose ngritë në prokurori kallëzime penale për deklarime të rreme.

Duke zbatuar mandatin e saj, Agjencia gjithashtu:

- rishqyrton ligjet për të siguruar që përfshijnë të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse kundër korrupsionit,
- monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit,
- monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit,

- vlerëson rrezikun e korrupsionit në sektorë të ndjeshëm, si prokurimi publik, punësimi dhe përdorimi i burimeve publike,
- rrit ndërgjegjësimin e publikut përmes fushatave dhe programeve edukative për dëmet që shkakton korrupsioni dhe nevojën për transparencë.

Sinjalizuesi

Sinjalizuesit luajnë një rol kyç në ruajtjen e integritetit dhe etikës në organizata dhe shoqëri. Veprimet e tyre mundësojnë zbulimin dhe raportimin e veprimeve të paligjshme, joetike ose të rrezikshme që përndryshe mund të mbeten të fshehta. Këto veprime, të cilat mund të përfshijnë korrupsion, mashtrim ose abuzim, shpesh kanë pasoja të rënda për shoqërinë, organizatën ose individët.

Në Ligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e Sinjalizuesve***, sinjalizuesi përkufizohet si çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat.***

Të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesve

Gjithashtu, sipas këtij Ligji[28], sinjalizuesi ka të drejtën e:

- brojtjes së identitetit të tij gjatë procesit të sinjalizimit;
- ruajtjen e fshehtësisë së burimit të informacionit të sinjalizuar;
- brojtjes kundër veprimeve të dëmshme.

Të drejtat e sinjalizuesit garantohen sipas këtij ligji si në vijim:

1] gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;

2] pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, me qëllim të kryerjes normale të detyrave funksionale të sinjalizuesit në marrëdhënien e vet të punësimit;

3] pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit me punëdhënësin e tij, kur nga rrethana të arsyeshme, sinjalizuesi ka kërkuar mbrojtjen sipas këtij ligji.

Analizat tregojnë se skandalet e mëdha korruptive zbulohen shpesh falë guximit të individëve që vendosën të raportojnë parregullsi. Megjithatë, mbledhja dhe zbulimi efektiv i informacionit për shkeljet në interes të publikut nuk duhet të varet vetëm nga guximi i individëve. Në vend të kësaj, është e nevojshme të krijohet një sistem i besueshëm që inkurajon të gjithë akterët në shoqëri të veprojnë në mënyrë parandaluese dhe të bashkëpunojnë me autoritetet kompetente. Nëse do të ekzistonte një sistem i tillë, shumë kërcënime ndaj interesit publik do të mund të parandaloheshin, pasi sinjalizuesit e mundshëm do të inkurajoheshin të ndajnë informatat e tyre me autoritete ose përmes mediave t'i ekspozojnë te publiku.

28] Neni 7, Të drejtat e sinjalizuesve

Nëpërmjet zbulimeve të tyre, sinjalizuesit ndihmojnë në mbrojtjen e interesit publik dhe mundësojnë zbatimin e drejtësisë, gjë që mund të çojë në reforma dhe avancime të rëndësishme në politika dhe procedura brenda organizatave. Ata kontribuojnë për një transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, që në të ardhmen rezulton në parandalimin e keq bërjeve dhe mbrojtjen e të tjerëve nga dëmtimet e mundshme.

Qasja në dokumente publike – hapi i parë në luftën kundër korrupsionit

Mekanizmat kundër korrupsionit përfshijnë një sërë qasjesh institucionale, ligjore dhe sociale që synojnë parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e praktikave korruptive.

Qasja në dokumente publike është një nga mekanizmat kyç në luftën kundër korrupsionit, pasi siguron transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore. Kur informacioni për punën e qeverisë, prokurimet publike, buxhetet dhe projektet vihet në dispozicion të qytetarëve dhe mediave, mundësia për të fshehur aktivitetet dhe keqpërdorimet e paligjshme zvogëlohet.

Qasja në dokumente jo vetëm që fuqizon qytetarët, por gjithashtu inkurajon institucionet të jenë të përgjegjshme. Kur ekziston mundësia e njohjes së aktiviteteve të tyre, agjencitë shtetërore dhe zyrtarët janë më të vetëdijshëm për detyrimin e tyre të punojnë në përputhje me ligjin dhe parimet etike. Ky proces mund të ndihmojë në identifikimin dhe parandalimin e keqpërdorimit të resurseve publike, duke mundësuar në të njëjtën kohë identifikimin e parregullsive dhe reagimin në kohë.

E drejta për qasje në informacion u jep qytetarëve fuqinë për të ndikuar në çështjet sociale dhe politike, duke forcuar kështu sistemin demokratik dhe zvogëluar hapësirën për korrupsion.

E drejta për qasje në informata publike në Kosovë rregullohet me Ligjin nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike[29], ndërsa zbatimi i tij monitorohet dhe mbikëqyret nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

29] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505

Agjencia për Informim dhe Privatësi

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), është agjenci e pavarur përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjit nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike.

Qëllimi kryesor i Agjencisë për Informim dhe Privatësi është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe garantimi i qasjes në dokumente publike, me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Agjencia për Informim dhe Privatësi merret me promovimin dhe informimin e institucioneve publike për zbatimin e këtyre ligjeve, në të njëjtën kohë ofron trajnime në fushën e mbikëqyrjes, sesione informuese, konferenca në institucione publike dhe më gjerë, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjit për qasje në dokumente publike.

E drejta për qasje në dokumente publike

Qasja në dokumente publike është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Që nga viti 2019, Kosova ka në fuqi Ligjin për qasje në dokumente publike, i cili në përgjithësi ka përmirësuar rregullimin ligjor dhe ka avancuar qasjen në dokumente publike.

Ligji është në përputhje me standardet ndërkombëtare në fushën e qasjes në dokumente publike, duke garantuar të drejtën e çdo personi fizik dhe juridik për qasje në dokumentet e institucioneve publike.

Neni 10 i Ligjit për qasje në dokumente publike përcakton qartë të drejtën për qasje në dokumente publike dhe parasheh se:

E drejta për qasje në dokumente publike i takon secilit person në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë.

Secili person ka të drejtë për qasje në dokumente publike në bazë të kërkesës. Kërkesa mund të bëhet nga personi, me shkrim, në formë elektronike, ose verbalisht. Nëse kërkesa nga kërkuesi bëhet verbalisht, zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike obligohet të hartojë kërkesën me shkrim për procedim të mëtejmë.

Secili person që parashtron kërkesë për qasje në dokumente publike nuk është i obliguar që të japë arsye për të pasur qasje në dokumente publike dhe ka të drejtë që të mbetet anonim në raport me palët e treta.

Kufizimi i të drejtës për qasje në dokumente publike bëhet vetëm në rastet e kufizuara dhe specifike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Institucioni publik detyrohet që brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe të informon kërkuesin për mjetet e ankimimit.

Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes ose mos përgjigjes së institucionit publik, secili person i cili beson se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Ligjin për qasje në dokumente publike mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje.

Mediat dhe shoqëria civile – kontrolli publik i punës së institucioneve

Lufta kundër korrupsionit përfaqëson një nga sfidat kyçe të shoqërive bashkëkohore, veçanërisht në vendet në tranzicion, ku institucionet shpesh janë të dobëta dhe kornizat legjislative janë të pamjaftueshme. Në këtë proces kompleks, si bartës të transparencës, përgjegjësisë dhe presionit social mbi elitat politike dhe ekonomike mediat dhe organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të pazëvendësueshëm. Aftësia e tyre për të hetuar, zbuluar dhe informuar publikun për rastet e korrupsionit i bën ata akterë kryesorë në krijimin e një shoqërie reziliente që kundërshton me sukses shpërdorimin e pushtetit.

Shoqëria civile, përfshirë mediat, duke promovuar transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë ka një rol kyç në kontrollin publik të institucioneve dhe luftën kundër korrupsionit. Aktivitetet e tyre përfshijnë monitorimin e punës së institucioneve, përfaqësimin e interesave të qytetarëve dhe rritjen e ndërgjegjësimit për korrupsionin. Organizatat e shoqërisë civile monitorojnë procese si prokurimi publik, shpenzimet buxhetore dhe zbatimi i ligjit, gjë që mundëson zbulimin e parregullsive dhe konflikteve të interesit, duke parandaluar keqpërdorimet.

Mediat përmes gazetarisë hetuese, publikimit të informacionit me rëndësi publike dhe presionit ndaj institucioneve për të reaguar, luajnë një rol të veçantë në ekspozimin e korrupsionit. Nëpërmjet prezantimit publik të fakteve dhe analizave, mediat fuqizojnë qytetarët dhe nxisin debatin publik për përgjegjësinë e institucioneve.

Përveç kësaj, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat avokojnë për reforma që forcojnë mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për të luftuar korrupsionin. Nëpërmjet nismave ligjore, fushatave publike dhe aksioneve civile, ushtrojnë presion mbi qeverinë për zbatimin e masave të duhura.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare siguron burime shtesë dhe mbështetje profesionale, e cila forcon ndikimin në institucionet vendore. Në këtë mënyrë, shoqëria civile dhe mediat funksionojnë si partnerë kryesorë në forcimin e integritetit dhe përgjegjësisë së institucioneve publike.

OJQ AKTIV – partner aktiv në luftën kundër korrupsionit

OJQ Aktiv është organizatë joqeveritare me bazë në Mitrovicën e Veriut që punon në mënyrë aktive në fuqizimin e angazhimit qytetar dhe përmirësimin e proceseve socio-politike në Kosovë. Një nga fushat kyçe të veprimtarisë së OJQ Aktiv është lufta kundër korrupsionit, ku në bashkëpunim dhe partneritet me Agjencinë Kosovare për Parandalimin e Korrupsionit dhe organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, implementon iniciativa dhe fushata të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për problemet e korrupsionit, organizon forume publike me qytetarë, duke avokuar në radhë të parë për transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve me qëllim të përmirësimit të politikave dhe mekanizmave në parandalimin e luftimin e korrupsionit në Kosovë.

Përmirësimi i transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe

OJQ Aktiv identifikon organizatat e shoqërisë civile si partnerë kyç në luftën kundër korrupsionit dhe i konsideron ato pjesë integrale të çdo përpjekjeje kundër korrupsionit në Kosovë.
Në kuadër të projektit ***Rritja e Transparencës dhe Sundimit të Ligjit në Komunitetet me Shumicë Serbe***, i cili zbatohet nga OJQ Aktiv dhe Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) nga Mitrovica e Veriut, në bashkëpunim dhe përkrahje të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe mbështetje financiare të Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), OSHC-të nga komuniteti serb, në bashkëpunim me OJQ Aktiv, kanë zbatuar iniciativa të ndryshme me trajtimin e temave si në vijim, fokusi i të cilave ishte transparenca dhe lufta kundër korrupsionit:

- Digjitalizimi dhe korrupsioni
- Kriptovalutat dhe korrupsioni
- Integriteti dhe strategjia në luftën kundër korrupsionit
- Fuqizimi i sinjalizuesve
- Fushata mediatike në luftën kundër korrupsionit
- Menaxhimi i mjedisit

Duke kuptuar rëndësinë e digjitalizimit të sistemeve të ndryshme brenda administratës shtetërore, por edhe vetë procesit të digjitalizimit në një kuptim më të gjerë, iniciativat kanë përfshirë disa segmente në identifikimin e kanaleve të reja korruptive në epokën digjitale dhe kontribuuan në parandalimin e aktiviteteve korruptive dhe edukimin për të sfidat e reja në luftën kundër korrupsionit.

KORRUPSIONI DIGJITAL – SFIDAT E EPOKËS MODERNE

Rrjeti për Aktivizëm Qytetar nga Graçanica përgatiti një Udhëzues për OSHC-të për luftimin e korrupsionit digjital *Korrupsioni digjital - sfidat e epokës moderne* i cili ofron njohuri themelore për korrupsionin digjital dhe sfidat digjitale në luftën kundër korrupsionit dhe prezanton mjete e burime për t'ua mundësuar organizatave të shoqërisë civile që në punën e tyre, veçanërisht në kuadër të luftës kundër korrupsionit në mënyrë më efikase të përdorin teknologjitë digjitale.

Udhëzuesi iu prezantua organizatave të shoqërisë civile në konferencën *Korrupsioni digjital - sfidat e epokës moderne*[30] të mbajtur në Graçanicë në shtator të vitit 2024. Si pjesë e iniciativës për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve për të luftuar korrupsionin digjital, Udhëzuesi iu shpërnda OSHC-ve aktive nga komunitetet jo shumicë në Kosovë, dhe është gjithashtu në dispozicion në faqen zyrtare të OJQ AKTIV[31].

KRIPTO DHE KORRUPSIONI – KUPTIMI I SFIDAVE DHE MUNDËSIVE

Kriptovalutat, monedhat digjitale ose virtuale që përdorin kriptografinë për çështje të sigurisë, kanë revolucionarizuar peizazhin financiar duke mundësuar transaksione të decentralizuara dhe anonime. Edhe pse këto atribute ofrojnë përfitime të konsiderueshme, të tilla si përfshirja e shtuar financiare dhe pagesat efikase ndërkufitare, gjithashtu paraqesin sfida unike, veçanërisht në lidhje me korrupsionin dhe krimin financiar.

Duke pasur parasysh që kriptovalutat njihen si një nga sfidat më atraktive në luftën kundër korrupsionit, ***Radio KIM*** si pjesë e iniciativës së tij ka prodhuar një sërë tekstesh me temën *Kripto dhe korrupsioni – Kuptimi i sfidave dhe mundësive*.

Në tekstet e disponueshme në faqen zyrtare të Radio KIM[32], diskutohen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me kriptovalutat: *Kriptovalutat – mundësitë, sfidat dhe cenueshmëria ndaj keqpërdorimeve*[33], *Përvojat e minatorëve kosovar dhe konsumi i energjisë elektrike*[34], *Kriptovalutat si mjete për ndryshime pozitive*[35], *Asetet digjitale dhe korniza legjislative e Kosovës*[36], *Revolucioni NFT: Popullariteti dhe polemika*[37].

Kjo seri u ofron lexuesve njohuri shtesë mbi proceset aktuale që lidhen me kriptovalutat, me fokus të veçantë në natyrën e tyre të dyfishtë.

30] Qasshme në linkun:https://radiokim.net/analiza/222642-rudarenje-kriptovaluta-koliko-elektricne-energije-se-zaistatrosi/
31] Radio KIM: https://radiokim.net/
32] Qasshme në linkun: https://radiokim.net/analiza/222101-kriptovalute-mogucnosti-i-izazovi-ranjivost-na-zloupotrebu/
33] Qasshme në linkun: https://radiokim.net/analiza/222642-rudarenje-kriptovaluta-koliko-elektricne-energije-se-zaistatrosi/
34] Qasshme në linkun: https://radiokim.net/analiza/223200-kriptovalute-kao-alati-za-pozitivne-promene/
35] Qasshme në linkun: https://radiokim.net/analiza/224982-digitalna-imovina-i-kosovski-zakonodavni-okvir/
36] Qasshme në linkun: https://radiokim.net/analiza/223756-nft-revolucija-popularnost-i-kontroverze/

GRAÇANICA – MES BETONIT DHE NATYRËS

Graçanicës. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes për sfidat mjedisore dhe korruptive në komunën e Graçanicës, shikuesve dhe ndjekësve në rrjetet sociale të Qendrës Mediale iu prezantua reportazhi *Graçanica - Mes betonit dhe natyrës,* ku problemi i ndërtimeve pa leje u analizua përmes identifikimit të shkaqeve dhe faktorëve që kontribuojnë në ndërtimet pa leje, por edhe mungesa e reagimit efektiv të autoriteteve komunale në respektimin e rregulloreve, të cilat për shkak të mungesës së transparencës në punë në këtë fushë, çojnë në korrupsion eventual.

Gjatë bisedave me ekspertë të fushës së mbrojtjes së ambientit, u prezantuan pasojat konkrete të ndërtimeve pa leje në ekosistemin lokal, me fokus të veçantë humbja e sipërfaqeve të gjelbra, përkatësisht tokës bujqësore.

Iniciativa si kjo inkurajojnë qytetarët që të jenë aktivë në mbrojtjen e burimeve të tyre natyrore, të ndjekin ligjshmërinë e ndërtimeve, të raportojnë aktivitete të dyshimta dhe të kërkojnë përgjegjësi nga autoritetet dhe institucionet lokale.

EDUKIMI I TË RINJVE TË GRAÇANICËS PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Edukimi i të rinjve për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin është një segment i rëndësishëm i forcimit të integritetit të vetëqeverisjes lokale dhe shoqërisë në tërësi. Si pjesë e kësaj iniciative, Qendra për Paqe dhe Tolerancë - CPT nga Graçanica zbatoi projektin Edukimi i të rinjve të Graçanicës për luftën kundër korrupsionit me qëllim të fuqizimit të të rinjve në Graçanicë për t'u bërë akterë kryesorë në ndërtimin e një komuniteti transparent e të përgjegjshëm.

Janë mbajtur dy sesione trajnimi dhe dy punëtori ku, përmes edukimit, simulimeve dhe pjesëmarrjes aktive, të rinjtë fituan njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në luftimin e korrupsionit. Puna me të rinjtë u fokusua në nevojat dhe specifikat lokale të Komunës së Graçanicës, duke përshtatur aktivitetet edukative për t'iu përgjigjur drejtpërdrejt sfidave dhe mundësive në atë komunitet.

Një komponentë kyçe e këtyre nismave që organizatat e shoqërisë civile i kanë zbatuar në bashkëpunim me OJQ Aktiv dhe Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) nga Mitrovica e Veriut, në kuadër të projektit Rritja e Transparencës dhe Sundimit të Ligjit në Komunitetet me Shumicë Serbe, është ndërgjegjësimi i publikut dhe fuqizimi i qytetarëve që të përfshihen aktivisht në luftën kundër korrupsionit, pavarësisht nga komuniteti nga i cili vijnë apo mosha e tyre, sepse lufta kundër korrupsionit na takon të gjithëve dhe është një detyrim i të gjithë neve.

37] Raporti i projektit i qasshëm në linkun: https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2024/11/Digitalna-korupcija.pdf

Rekomandime

Lufta kundër korrupsionit është me interes publik kyç dhe kërkon zbatimin e parimeve gjerësisht të pranuara dhe praktikisht të provuara. Nuk varet nga qëndrimet ideologjike, por nga gatishmëria për të ndjekur angazhimet dhe dokumentet strategjike ndërkombëtare, si dhe nga respektimi i vlerësimeve të organizatave përkatëse dhe komunitetit. Këto rekomandime ofrojnë udhëzime për një luftë efektive kundër korrupsionit në kontekstin e integrimit në BE dhe nevojave të shoqërisë.

Rekomandime për institucione →

Në këtë pjesë, ofrojmë udhëzime për përmirësimin e praktikave institucionale në luftën kundër korrupsionit, udhëzime dhe rekomandime që synojnë ndërtimin e një sistemi efektiv për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, me qëllim të përmirësimit të sektorit publik dhe forcimit të besimit të qytetarëve tek institucionet. Rekomandimet kryesisht janë të dedikuara për Qeverinë e Kosovës dhe agjencitë e saj vartëse.

Zbatimi dhe avancimi i kornizës ligjore

Të sigurohet zbatimi i qëndrueshëm i ligjeve dhe politikave ekzistuese kundër korrupsionit, me përditësime të rregullta dhe përafrim me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

Të zhvillohet dhe miratohet në bashkëpunim me institucionet përkatëse Strategjia kombëtare për luftën kundër korrupsionit në Kosovë.

Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies

Të zbatohen mekanizmat për rritjen e transparencës në punën e institucioneve, duke përfshirë publikimin e detyrueshëm të informacionit lidhur me shpenzimet, vendimmarrjen dhe kontratat.

Mbështetja për organet e pavarura kundër korrupsionit

Të sigurohet përkrahja dhe resurset adekuate për institucionet e pavarura kundër korrupsionit, si Agjencia për Parandalimin Korrupsionit dhe organet e tjera përkatëse.

Trajnimi dhe edukimi

Të organizohen trajnime të rregullta për punonjësit e sektorit publik mbi masat kundër korrupsionit, etikën dhe integritetin, me qëllim të ngritjes së aftësive dhe njohurive të tyre në njohjen, identifikimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe mediave

Të inkurajohet pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile dhe mediave në monitorimin dhe raportimin e korrupsionit, përmes mundësimit të qasjes në informacion dhe mbrojtjes së gazetarëve dhe aktivistëve që merren me temën e korrupsionit.

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Të shkëmbehen përmes bashkëpunimit me organizata dhe partnerë ndërkombëtarë përvojat, informacionet dhe praktikat më të mira në luftën kundër korrupsionit, duke kontribuar kështu në përpjekjet globale për të luftuar korrupsionin.

Për mediat

Forcimi i gazetarisë hulumtuese

Mediat duhet të investojnë në gazetarinë hulumtuese si një mjet kyç për ekspozimin e aktiviteteve të korrupsionit. Ky lloj i gazetarisë jo vetëm që hedh dritë mbi praktikat që cenojnë integritetin e sistemit, por gjithashtu kontribuon në ndërgjegjësimin dhe mobilizimin e shoqërisë civile.

Përmirësimi i transparencës

Media duhet të kërkojë dhe të insistojë për qasje në informacionin publik. Promovimi i ligjeve për të drejtën e qasjes në informacion dhe realizimi i fushatave publike që kërkojnë nivele më të larta të transparencës nga institucionet mund të ndihmojnë në hedhjen e dritës mbi aktivitetet sekrete dhe potencialisht korruptive.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi

Nëpërmjet programeve edukative dhe informative, media mund të luajë një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimit për dëmet e pasojat e korrupsionit. Edukimi i qytetarëve për të drejtat e tyre, mënyrat për të raportuar korrupsionin dhe pasojat e veprimeve korruptive mund të rrisë rezistencën e publikut ndaj korrupsionit.

Promovimi i integritetit

Media duhet të jetë model i gazetarisë etike dhe integritetit. Gazetarët të cilët promovojnë profesionalizmin, paanshmërinë dhe përgjegjësinë mund të kontribuojnë në ndërtimin e besimit të qytetarëve te gazetaria si një mjet për të luftuar korrupsionin.

Krijimi i platformave për dialog

Mediat të ofrojnë platforma për dialog mes qytetarëve, ekspertëve dhe vendimmarrësve. Me organizimin e debateve publike, forumeve dhe diskutimeve mbi temën e korrupsionit, mediat mund të kontribuojë në krijimin e zgjidhjeve konstruktive dhe ushtrimin e presionit mbi autoritetet.

Për organizatat e shoqërisë civile

Monitorimi dhe mbikëqyrja e punës së institucioneve

Organizatat e shoqërisë civile duhet të përdorin burimet e tyre për monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të punës së institucioneve publike. Vendosja e mekanizmave sistematikë për monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të transparencës dhe llogaridhënies së organeve qeveritare mund të ndihmojë në identifikimin e dobësive sistematike dhe ofrimin e rekomandimeve për reforma konkrete.

Avokimi dhe propozimi i reformave

Avokimi aktiv i shoqërisë civile mund të luajë një rol kyç në formësimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit. Kjo nënkupton propozimin e reformave të reja ligjore dhe rregullatore, si dhe organizimin e fushatave që ushtrojnë presion mbi autoritetet për të marrë masat e nevojshme.

Mbështetje për viktimat e korrupsionit

Shoqëria civile duhet të ofrojë mbështetje dhe mbrojtje për personat që raportojnë ose luftojnë kundër korrupsionit. Kjo mund të përfshijë ndihmë ligjore, këshilla për privatësinë dhe mbështetje në rast të kërcënimeve ose hakmarrjes.

Bashkëpunimi me mediat

Organizatat e shoqërisë civile duhet të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me mediat për të përhapur informacione për korrupsionin. Iniciativat e përbashkëta me gazetarët mund të kontribuojnë në informimin më të mirë të publikut dhe forcimin e përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit.

Ngritja e kapaciteteve vetanake

Shoqëria civile për të kryer funksionin e saj në mënyrë më efikase duhet të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve dhe burimeve të veta. Kjo përfshin trajnime për anëtarët e organizatës, zhvillimin e aftësive analitike dhe përmirësimin e metodologjive për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.

Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, mediave dhe shoqërisë civile

RREGULLORE PËR BASHKËPUNIMIN E AGJENCISË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAT

Agjencia në bashkëpunim me OSHC-të dhe mediat duhet të hartojë dhe miratojë Rregulloren për bashkëpunimin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, ku do të përcaktohen format e bashkëpunimit, do të vendosen kanalet formale të komunikimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat, që të sigurohet përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse dhe monitorimin e punës së Agjencisë, duke reduktuar në këtë mënyrë paqartësitë dhe pasiguritë në lidhje me mënyrat se si ndahet informacioni dhe koordinohet puna ndërmjet akterëve të ndryshëm në luftën kundër korrupsionit.

Rekomandime për qytetarët

INFORMOHUNI

Mësoni se çfarë është korrupsioni, si manifestohet dhe cilat janë pasojat. Edukimi për të drejtat dhe ligjet mund t'ju ndihmojë në identifikimin e korrupsionit.

RAPORTONI KORRUPSIONIN

Nëse dyshoni se jeni dëshmitar i korrupsionit, raportojeni atë tek institucionet përkatëse si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Mos kini frikë të raportoni - mbrojtja e sinjalizuesve dhe atyre që raportojnë është pjesë e rëndësishme në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Si të raportohet korrupsioni në Kosovë?

Raportimi i korrupsionit në Kosovë mund të bëhet përmes disa kanaleve të ofruara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

PERSONALISHT APO PËRMES POSTËS

Qytetarët mund drejtpërdrejt të raportojnë rastin personalisht ose me shkrim në adresën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Është e nevojshme që të ofrohen sa më shumë informacion për rastin e korrupsionit, duke përfshirë emrat, datat dhe të dhënat e tjera përkatëse.

ADRESA E AGJENCISË:

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë / Agencija za sprečavanje korupcije
Rr/ Ul. Shkodra, nr. 6, 10000 Prishtinë, Kosovë.

PËRMES TELEFONIT

Rastet e korrupsionit mund të raportohen përmes telefonit duke telefonuar në numrin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Në varësi të burimeve të disponueshme, mund të ekzistoj një linjë telefonike e dedikuar për raportime anonime.

Telefoni: 0800 10 800

RAPORTIMI ONLINE

Qytetarët mund të raportojnë korrupsionin duke përdorur formularin në faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Raportimi i rastit mund të jetë anonim ose me të dhëna personale. Inkurajohen qytetarët të japin informacion sa më të saktë.

Ueb faqja: https://apk-rks.net/

POSTA ELEKTRONIKE (E-MAIL)

Raportimi i korrupsionit mund të bëhet edhe përmes postës elektronike, duke dorëzuar dokumentacionin ose informacionin rreth veprimeve të pretenduara korruptive.

E-mail: info.apk@rks-gov.net

RAPORTIME ANONIME

Nëse personi dëshiron të mbetet anonim, ai/ajo përmes një formulari në internet ose me telefon mund të raportoj rastin pa zbuluar identitetin e tij/saj. Agjencia pranon raportime anonime, mirëpo ato duhet të përmbajnë informacion të mjaftueshëm për t'u hetuar.

Çfarë duhet të përmbaj raportimi i rasti?

Për raportim të rastit:

- Përshkruani situatën dhe natyrën e korrupsionit
- Emrat ose identitetin e personave të përfshirë (nëse janë të njohur)
- Datën dhe vendin e ngjarjes
- Çdo provë (dokument, fotografi, incizim) që mund të ndihmojë hetimin

Të gjitha raportimet trajtohen me kujdes dhe konfidencialitet dhe Agjencia është e obliguar t'i hetojë ato në përputhje me ligjin.

Platforma të tjera për raportimin e korrupsionit

APLIKACIONI ABER

Aplikacioni Aber është një mënyrë inovative për raportimin e korrupsionit dhe është zhvilluar si rezultat i projektit ***Rritja e Transparencës dhe Sundimit të Ligjit në Komunitetet me Shumicë Serbe***, i cili zbatohet nga *OJQ AKTIV dhe Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)*, në bashkëpunim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit. Projekti u mbështet financiarisht nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL), me qëllim të fuqizimit të sundimit të ligjit dhe integritetit në institucione.



Përmes aplikacionit ***Aber***, qytetarët mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në luftën kundër korrupsionit duke raportuar aktivitete të dyshimta dhe korruptive. Aplikacioni mundëson raportimin e rasteve të ryshfetit, shpërdorimit të detyrës, parregullsive në prokurimet publike dhe formave të tjera të korrupsionit. Të gjitha raportimet i dërgohen drejtpërdrejt Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, gjë që rrit transparencën dhe përgjegjësinë e institucioneve publike.

Aplikacioni është në dispozicion në Google Play Store dhe platformën IOS (Apple Store).

Aplikacioni ***Aber*** gjithashtu u ofron përdoruesve qasje në informatat kyçe për të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e komuniteteve jo shumicë, si dhe udhëzime rreth institucioneve dhe mekanizmave për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Është i dedikuar për të gjithë qytetarët e Kosovës, e veçanërisht për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, dhe është i qasshëm në pesë gjuhë: serbe, shqipe, turke, rome dhe gorane.

PLATFORMA ONLINE KALLXO.COM

Platforma online **www.kallxo.com** u ofron mundësi të gjithë qytetarëve të Kosovës të raportojnë rastet e korrupsionit, krimit të organizuar, mashtrimit, konfliktit të interesit, si dhe të gjitha rastet e tjera të keqpërdorimit të pozitës zyrtare, neglizhencës, përtacisë, mos kryerjes së detyrave, rrezikimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës, apo rrezikimit të interesave të përgjithshme. Korrupsioni mund të raportohet në të gjitha fushat, duke përfshirë pushtetin qendror dhe lokal, arsimin, shëndetësinë, gjyqësorin, ekonominë, etj.

Raportimi i rastit në www.kallxo.com mund të bëhet në mënyrat e mëposhtme:

SMS – dërgoni një mesazh SMS në numrin **044/ 224 - 498**.
Teksti i mesazhit duhet të jetë sa më i qartë dhe të përshkruajë rastin e raportuar në mënyrë sa më të detajuar.

Përmes internetit në adresën **www.kallxo.com**, në rubrikën ku shkruan RAPORTO.

Identiteti i qytetarëve që raportojnë rastet mbetet konfidencial dhe do të ruhet nga ekipi i www.kallxo.com, pavarësisht nëse këta qytetarë kanë dhënë apo jo informacion për identitetin e tyre.

Manuali zbatohet në kuadër të projektit "Përmirësimi i transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe", i cili zbatohet nga OJQ AKTIV dhe Qendra për Kulturë Demokratike (ACDC), me bashkëpunim dhe mbështetjen e Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me mbështetjen financiare të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe zbatimit të ligjit (International Narcotics and Law Enforcement Affairs Bureau – INL).

OJQ AKTIV.ORG